



Prishtinë, 31.03.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1504_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2172_05_21** i dt.24.05.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **24.05.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **31.03.2022** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin I.L., nga komuna e Deçanit, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2172_05_21, i datës 24.05.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 24.05.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2172_05_21 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit I.L., dhe e ka obliguar KESCO-n që ta shkarkojë konsumatorin nga fatura e dt. 23.11.2020 me shpenzim mujor prej 89,574 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 4,177.87 EUR dhe po ashtu, ZRrE e ka obliguar KESCO-n që për periudhën kontestuese, ta ngarkoj konsumatorin me shpenzim të energjisë elektrike prej 65.30 kWh/muaj.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhën 11/2020 është i saktë dhe i njëjti është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsorin nr. 3518136 dhe se korrigjimi financiar i kontestuar, ka përfshirë vetëm faturimin/shpërndarjen e kWh të regjistruar në njehsor dhe për periudhën 05/2018 e deri me 10/2018 është bërë faturimi gjashtë (6) mujor, sipas mesatares që ishte prej 1081.92 kWh/muaj bazuar në shpenzimin për periudhën 11/2020 deri me 04/2020.
- Duke u bazuar në procesverbalin e dt. 19.08.2020, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, pas inspektimit të pikës matëse, kanë konstatuar që, nuk kanë qasje për verifikim të gjendjes së njehsorit dhe është konstatuar kyçja ilegale në rrjet, dhe si rrjedhojë, KESCO e ka bërë faturimin plotësues për periudhën 6 mujore.



- ZRrE vendimin e saj e arsyeton në rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe në krahasimin e shpenzimeve pas pranimit të instalimit elektrik, dhe nuk e ka marr parasysh faktin se, njehsori ka qenë i kyçur në mënyrë ilegale.
- Apeluasi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2172_05_21 i datës 24.05.2021 për konsumatorin I.L.,.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi për periudhën 11/2020 është i saktë, ZRrE thekson se, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, si Kërkesës së konsumatorit në KESCO të dt. 06.10.2020, Procesverbalit të Inspektimit të dt. 19.08.2020, Procesverbalit të pranimit të instalimit elektrik të dt. 13.11.2020, Procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, Transaksionet e konsumatorit, Kërkesat e konsumatorit në KESCO e dt. 23.11.2020 dhe dt. 25.11.2020, Ankesën e konsumatorit në DMK të dt. 05.01.2021, Deklaratat e noterizuara dhe korrespondenca në mes të ZRrE-së dhe KESCO-s, dokumentet e KEDS për “Illegal customers”, Urdhërlejimin e dt. 23.04.2021, dhe Rrjedhën e energjisë elektrike aktive, ka gjetur se, ky pretendim nuk qëndron si i tillë, sepse, nga të gjitha provat e përmendura si më lartë, pa mëdyshje vërtetohet fakti se, faturimi i dt. 23.11.2020 me shpenzim mujor prej 89,574 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 4,177.87 EUR nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimet mujore reale të konsumatorit, e që prej periudhës 11/2020 e deri me 04/2021 është 65.30 kWh/muaj, pra, nuk përkon as për së afërmi me faturimin e ngarkuar nga KESCO. Po ashtu, edhe korrigjimi i dt. 23.04.2021 në vlerë prej -2,194.45 EUR nuk është i saktë, sepse, siç është konstatuar në vendimin e apeluar, nuk është vërtetuar saktë gjendja e njehsorit elektrik, pasi që KEDS nuk i ka zbatuar rregullat dhe procedurat në fuqi.

Në një vështrim kronologjik të këtij rasti, ZRrE gjen se, konsumatori fillimisht kishte parashtruar kërkesë për lidhje të re në KESCO. Pas inspektimit të pikës matëse, punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë konstatuar se, shtëpia e konsumatorit është e mbyllur dhe nuk kanë qasje në të dhënat e njehsorit. Rrjedhimisht, ZRrE ka analizuar me kujdes këtë procesverbal të dt. 19.08.2020 dhe ka gjetur se, që nga kjo datë, e deri me 16.11.2020, KEDS nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta identifikuar konsumatorin si shfrytëzues i pa kontraktuar i energjisë elektrike, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 32 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike si dhe nenit 9 të Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, pasi që është dashur që të bëhet shkyçja e objektit nga rrjeti elektrik, përpilimi i procesverbalit të inspektimit dhe udhëzimi i palës për hapat e mëtejme për nënshkrimin e kontratës për furnizim, pas plotësimit të kushteve teknike. Pra, për rreth 3 muaj, KEDS nuk e ka ndërmarrë asnjë nga veprimet procedurale të legjislacionit sekondar në fuqi.

Për më tepër, pas analizimit të procesverbaleve të dt. 13.11.2020, ZRrE ka gjetur se, njehsori elektrik i kontestuar nr. 3518136 me gjendje TL=33153 dhe TU=56421 kWh, është i vitit 1978, dhe nuk është dhënë asnjë sqarim lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike, pasi që, shpenzimi prej 89,574 kWh, nuk mund të jetë shpenzim mujor i energjisë elektrike. Përsëri, i licencuari KEDS dështon



që ofrojë informacione rreth këtij shpenzimi, e kjo në kundërshtim me nenin 26 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike dhe nenit 3 të Procedurës së Leximit dhe Faturimit, ashtu që, leximi i konsumatorëve duhet të bëhet për çdo muaj, dhe është dashur që të evidentohet nëse konsumatori është i kyçur në rrjetin elektrik ose jo, e siç është vënë re nga fotografitë e vendbanimit, kemi të bëjmë me lagje, ku ka edhe shtëpi të tjera, dhe është konstatuar se, ka qenë e pamundur që punëtorët e KEDS-it të mos e vërejnë një kyçje të tillë, për muaj e vite me radhë.

Gjithashtu, përmes disa deklaratave të noterizuara, e të siguruara nga ana e konsumatorit, ZRrE e ka vërtetuar faktin se, konsumatori I.L., jeton në Prishtinë dhe se njehsori nr. 3518136 ka qenë i konsumatorit M.T.

Nga korrespondenca e zhvilluar në mes të ZRrE-së dhe KEDS, është siguruar dokumenti në formatin Excel me titull "DPE_UnregisteredDebitor_I.L.", dhe ZRrE ka gjetur se, me datë 24.10.2018 KEDS e ka evidentuar njehsorin elektrik në emër të I.L., me gjendje TL=26897 kWh dhe TU=56421 kWh, por që, në të njëjtin dokument është vënë re edhe shifra DPE – 906897, e hapur nga KESCO me datë 16.11.2020. Pra, në të njëjtin dokument, janë vërejtur mospërputhje të të dhënave të gjendjes së njehsorit dhe të datave. Kësisoj, KEDS nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të evidentuar se konsumatori është kyçur në rrjetin elektrik dhe ka bërë shpenzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Duke u bazuar në Rrjedhën e Energjisë Elektrike, ZRrE e ka vërtetuar faktin se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse. Konsumatori me datë 13.11.2020 (i regjistruar në KESCO me datë 16.11.2020) ka pasur në funksion njehsorin elektrik nr. 3518136 dhe se në po atë datë është larguar nga matja dhe është vendosur njehsori elektrik nr. 75481822. Nga analiza e bërë shpenzimin të energjisë elektrike me njehsorin e ri, rezulton se, mesatarja mujore e shpenzimit është 65.30 kWh/muaj, e që nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimin e energjisë elektrike të faturuar nga KESCO si shpenzim mujor të periudhës 11/2020 prej 89,574 kWh.

Më tej KESCO, me datë 23.04.2021 ka nxjerrë një Urdhërlejim, duke e korigjuar konsumatorin në vlerë prej -2,194.45 EUR, duke korigjuar kështu kilovatorët për periudhën 11/2018 – 11/2020, e kjo shpërndarje e shpenzimit të energjisë elektrike është bazuar në raportimet e lexuesit për njehsorin ilegal, me datë 24.10.2018 me gjendje TL=6105 kWh dhe TU=65421 kWh, si dhe faturimi i shpenzimit prej 1,081.92 kWh për periudhën 05/2018 e deri me 10/2018 (periudha 6 mujore). Pra, përsëri, edhe ky korigjim, nuk përkon as për së afërmi me shpenzimin e konsumatorit pas periudhës kontestuese. Për më shumë, nuk është dhënë asnjë arsye se përse KESCO e ka ngarkuar konsumatorin për periudhën 05/2018 deri me 10/2018.

Në nenin 5, paragrafi 3, nën paragrafi 3.9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, theksohet se: *Operatori i Sistemit duhet të sigurojë lexim të saktë dhe të Rregullt të njehsorëve. Në kreun III të Rregullës në fjalë është e përshkuar i gjithë procesi i kyçjes së konsumatorit, nga aplikimi për kyçje e deri te kyçje fizike.* Gjithashtu neni 32 i Rregullës në fjalë, e potencon se si cilësohet shfrytëzimi i pa kontraktuar, pra shfrytëzimi i energjisë në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë, si dhe konsumatorët nuk duhet të ndryshojnë ose kryejnë ndonjë veprim në kyçje, pajisje matëse dhe aparate pa pëlqimin me shkrim nga ndërmarrja e energjisë, dhe janë të obliguar që të raportojnë te furnizuesi sapo të kuptojnë për ndonjë prishje të shkaktuar në kyçje dhe në pajisjet matëse. Për më tepër ZRrE thekson se në nenin 28 paragrafin 1 të



Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se:” 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)*”. Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës shihet qartë se tek ky rast, KESCO fillimisht e ngarkon konsumatorin I.L., me shpenzim mujor prej 89,574 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 4,177.87€ **pa analizuar fare si ka ardhur deri te ky shpenzim por vetëm bazuar në procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik** nr.0096974 të datës 13.11.2020, dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.084973 të datës 13.11.2020. Pastaj me datë 23.04.2021 konsumatorit në fjalë i bënë një korigjim -2,194.45 €, në arsyetimin se për afro dy vite më parë 24.10.2018 lexuesi i KEDS ka evidentuar një gjendje të njehsorit elektrik nr.3518136 e cila gjendje e shpenzimit (27,048 kWh) nuk është si ajo e evidentuar në procesverbalet e datë 13.11.2020. KESCO dhe KEDS gjithashtu ka theksuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit nr.3518136 nuk është evidentuar përmes procesverbaleve, siç e parashohin rregullat dhe procedurat në fuqi, por vetëm është evidentuar në regjistrat e brendshëm të KEDS, dhe asnjë procesverbal nuk është përpiluar nga ana e KEDS **në të cilën do të evidentohet se kemi të bëjmë me një kyçje që nuk është lejuar nga ndërmarrja**, ashtu siç specifikohet në nenin 32 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe nenit 9, paragrafi 9.1 të Procedurës për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Pra, KEDS këto veprime i ka ndërmarr tek pas dy viteve e për të cilat sipas KEDS janë vetëm evidencime në regjistrat e tyre dhe jo të bëra përmes procesverbaleve. Gjithashtu shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit pas periudhës së kontestuar, nuk përputhet me shpenzimin e faturuar në muajin 11/2020 e as me gjendjen e shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës 11/2018 – 11/2020. Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, ZRrE konstaton se KESCO dhe KEDS nuk kanë arritur të argumentojnë faktin se faturimi nr.1120121532DPE-9068207 të datës 23.11.2020 me shpenzim mujor prej 89,574 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 4,177.87€, është i saktë, andaj Bordi thekson se, DMK me të drejtë ka konstatuar faktin se KESCO duhet ta shkarkoj konsumatorin nga kjo faturë e energjisë elektrike. Gjithashtu Bordi konstaton se edhe korigjimi KEDS nr.61497DPE-9068207-9068207 i datës 23.04.2021 prej -2,194.45€, nuk është i saktë, pasi që nuk mund të vërtetohet saktë gjendja e njehsorit elektrik nr.3518136 sepse KEDS nuk ka zbatuar rregullat dhe procedurat në fuqi, si dhe ky korigjim nuk përputhet me shpenzimin e periudhës 11/2020 e deri më 04/2021 është 65.30 kWh/muaj. Andaj, në pamundësi të vërtetimit të saktë të gjendjes së shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr.3518136 në periudhën 24.10.2018, dhe se pasi që KEDS ka evidentuar njehsorin në fjalë te konsumatori I.L., me datën 24.10.2018, atëherë Bordi ri konfirmon qëndrimin se, KESCO konsumatorin I.L., duhet ta ngarkoj nga data 24.10.2018 e deri më 11/2020 me shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës 11/2020 - 04/2021 prej 65.30 kWh/muaj.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit I.L., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.